

VENDIM
Nr. 240, datë 14.4.2021

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHIJAK TË OBJEKTIT ARSIMOR,
SHKOLLA E MESME E BASHKUAR “KAJO KARAFILI”, BASHKIA SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Shijak të objektit arsimor shkolla e mesme e bashkuar “Kajo Karafili”, Bashkia Shijak, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA PËR OBJEKTET ARSIMORE (TABELA NR. 1)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërtimit	Financimi i ndërtimit	Sipërfaqe (m ²)	Vlera e projektidesë	Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e mbikëqyrjes	Vlera e kolaudimit	Vlera totale e objektit
17	Bashkia Shijak	Shijak	Mamurras	E mesme	Kajo Karafili	Ndërtim	Buxhet GoA	2,895.0	644,700.00	123,500,562.00	1,313,298.00	118,389.22	125,576,949.22
TOTAL								2,895.0	644,700.0	123,500,562.0	1,313,298.0	118,389.2	125,576,949.2